



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.13567/8793/3876 (31025-02897-86-2016) Rregj.Them.

Data Regjistrimi 13.06.2016



VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR – Alkelina GAZIDEDJA
GJYQTAR – Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Asistuar nga sekretare gjyqësore [REDACTED] në Tiranë, sot më datë 15.01.2019,
shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore,
Gjirokastër, me adresë: Rruga Nacionale Gjirokastër-
Kakavijë.

I PADITUR: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë,
me adresë: Rruga "Sami Frashëri" nr. 10, kati II, (tek
godina e FSHZH-së).

Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve
nr.127, datë 07.09.2015, si dhe nr. 157, datë
04.11.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga
Diskriminimi.

BAZA LIGJORE: Neni 153, 154 të K.Pr.Civile; ligji nr.49/2012 "Për
organizimin dhe funksionimin e gjykatave
administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve
administrative"; ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "Për
mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me
vendimin nr. 1346 ,datë 18.03.2016 ka vendosur:

1. Rrëzimin e padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore,
Gjirokastër, si të pambështetur në ligj dhe në prova.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor, pala paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shodërore, Gjirokastër në datën 29.04.2016.

Pala paditëse në ankimin e paraqitur prej saj ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke parashtruar se:

1. z. [REDAKTUAR] ka qënë punonjës pranë DRSSII Gjirokastër, Agjencia Tepelenë që nga viti 1996 deri në Prill të vitit 2014 sipas vendimit nr.3/2 datë 26.02.2008 "Për mirtimin e rregullores" "Për personelin e ISSII" pika VI/3/g "Transferimi, pezullimi dhe largimi nga puna" rezultoi se profesioni nuk kishte përshtatshmëri me kërkesat e vendit të punës pasi kërkonte kualifikimin "Specialist /i lartë" dhe arsimi dhe kualifikimi i tij nuk përputheshin me pozicionin.
2. z. [REDAKTUAR] kishte arsim të mesëm, madje dhe jashtë profilit të pozicionit. Personit i është zgjidhur kontrata e punës dhe ai i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër e cila është shprehur me vendimin nr.339 datë 22.05.2014 dhe Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi këtë vendim. Nga ana e DRSSH Gjirokastër është ekzekutuar vendimi dhe personi ka marrë shumën e vendosur në urdhrin e ekzekutimit për sa i përket kërkimit për pagesën e raportit, kjo çështje është duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk ka marrë formë të prerë pretendimi i tij se ka qënë me raport në momentin e largimin nga puna.
3. Pretendimet e tij se është diskriminuar për shkak të shëndetit dhe arsimit nuk qëndrojnë dhe nuk janë të provueshme. Në momentin që nuk ka patur kualifikimin e nevojshëm dhe arsimin e përshtatshëm, në këto kushte nuk është diskriminuar dhe çdo veprim është në përputhje me dispozitat ligjore.
4. Sa sipër pala paditëse përfundimisht kërkon, ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoji relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr.49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në datën 10.11.2015 me kërkesë padi duke kërkuar:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 127, datë 07.09.2015, si dhe nr.157, datë 04.11.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pala paditëse në lidhje me këtë kërkim ka referuar si bazë ligjore, nenet 153, 154 të K.Pr.Civile; ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, e cila me vendimin nr. 666 datë 16.12.2015 ka vendosur: "Të deklarojë moskompetencën territoriale për gjykimin e çështjes dhe kalimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të çështjes me vendimin nr. 1346, datë 18.03.2016, ka vendosur: Rrëzimin e padisë së palës paditëse

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim palë paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Gjirokastrë, brenda afatit ligjor, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesë padisë.

Në këtë rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 1346, datë 18.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 40, datë 04.05.2015 e shtetasit z. [REDAKTUAR] në të cilën pretendohet diskriminimi për shkak të gjëndjes arsimore dhe gjëndjen shëndetësore, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi është punësuar pranë DRSSH Gjirokastrë në muajin Qershor 1996, si Inspektor i sigurimit vullnetar dhe në muajin Prill 2014 është liruar nga detyra me motivacionin "Mospërputhje e arsimit me vendin e punës".

Ndër të tjera ankuesi shprehet se është larguar nga puna, ndërkohë që ka qënë me raport mjekësor.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 413/1, datë 06.05.2015, ku kërkohej informacion lidhur me çështjen e ankuesit [REDAKTUAR] si dhe DRSSH Gjirokastrë për dokumentacionin e nevojshëm, në përgjigje të së cilës, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë ka dërguar shkresën nr. 1803/1, datë 13.05.2015, ku jepen sqarimet përkatëse mbi çështjet e ngritura nga z. [REDAKTUAR]

Referuar shkresës së sipërcituar të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë z. [REDAKTUAR] është paguar nga ky institucion me motivacionin "mospërputhje e arsimit me vendin e punës" z. [REDAKTUAR] ka arsim të mesëm ekonomik, ndërkohë që në bazë të strukturës organizative të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë, në pozicionin e punës "specialist i sigurimit vullnetar" kërkohej arsim i lartë. Me këtë motivacion, janë larguar nga puna 11 punonjës nga DRSSH Gjirokastrë. Në vend të z. [REDAKTUAR] është punësuar z. [REDAKTUAR] e cila ka arsimin e lartë në Degën Ekonomi. Bashkëlidhur shkresës në fjalë, DRSSH Gjirokastrë ka dërguar të gjithë dokumentacionin përkatës, të kërkuar nga Komisioneri.

Në vijim të procedurave hetimore, referuar Urdhrit nr. 97, datë 11.06.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me qëllim kryerjen e verifikimeve, mbi ankesën e z. [REDAKTUAR]", ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 24.06.2015, kreu inspektim Drejtorisë.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektoreve të KMD-se u takua me z. [REDAKTUAR] me detyrë Kryetar i Degës së Administrimit të DRSSH Gjirokastrë, i cili dha sqarimet përkatëse lidhur me çështjet që përbënin objektin e inspektimit. Sipas tij, z. [REDAKTUAR] është larguar nga detyra si rrjedhojë e mospërputhjes së arsimit me vendin e punës, sepse në bazë të strukturës së institucionit, në pozicionin e punës së ankuesit kërkohej si kriter arsimi i lartë. Menjëhere pas emërimit në detyrë të Drejtorit të ri të DRSSH Gjirokastrë, në

muajin Nëntor 2013, u morën të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e strukturës përkatëse të këtij institucioni.

Referuar strukturës organizative të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër për vitin 2009, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pozicionin "specialist i sigurimit vullnetar" është përcaktuar si kriter "arsimi i lartë". Në këtë pozicion pune ka qënë punësuar z. [REDAKTUAR] i cili referuar shënimeve në librezën e tij të punës dhe karakteristikave të administruara në dosjen e tij personale të punës, ka kryer arsimin e mesëm, Dega Ekonomi Agrare.

Gjithashtu, në çështjen administrative me paditës - [REDAKTUAR] palë të paditur - Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër dhe me objekt gjykimi - detyrim pagim dëmshpërblimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara nga punëdhënësi etj., Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, referuar vendimit të saj nr. 339, datë 26.05.2014, ndër të tjera është shprehur: "*Pretendimi i anës së paditur të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për shkak të mospërputhjes së vendit të punës me kualifikimin e paditësit nuk përbën shkak të ligjshëm dhe të bazuar në prova. Paditësi për më shumë se 20 vjet ka punuar pranë anës së paditur dhe pas kësaj periudhe kohe pretendohet për mospërputhje të vendit të punës me kualifikimin e paditësit. Paditësi me të njëjtin kualifikim ka kryer detyrimet kontraktore për rreth njëzet vjet dhe se gjatë kësaj periudhe nuk është ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore, në asnjë rast nuk ka shkelur detyrimet kontraktore*".

Ky vendim sipas pretendimeve në padi, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tirane dhe është ekzekutuar.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, KMD ka konkluduar se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e DRSSH Gjirokastër.

Me vendim nr.127, date 07.09.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur:

"1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjëndjes arsimore dhe gjëndjes shëndetësore të z. [REDAKTUAR] nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër.

2. Referuar pikës 1 të këtij vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, për rikthimin në punë të z. [REDAKTUAR]

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, date 04. 02. 2011 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni".

Në pjesën arsyetuese të vendimit, KMB argumenton si më poshtë: "*Në bazë të hetimit administrativ rezultoi se z. [REDAKTUAR] ka filluar punë pranë DRSSH Gjirokastër në datën 01.07.1993 dhe referuar librezës së punës, atij i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.04.2014. Referuar Raportit për Paaftësi të Përkohshme në punë nr. 2106 Regjistri, datë 31.03.2014, lëshuar nga Qendra Shëndetësore Tepelenë, ankuesit i është dhënë pushim për 14 ditë, pushim i cili fillonte në datën 01.04.2014 dhe përfundonte në datën 15.04.2014.*

Raporti i mësipërm është ndjekur edhe nga disa raporte të tjera, deri në datën 16.07.2014. Në çështjen administrative me paditës - [REDAKTUAR] palë të paditur - Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër dhe me objekt gjykimi - detyrim pagimi i

raportit për paaftësi të perkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhet nga punëdhënësi etj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, referuar vendimin e saj nr. 678, datë 04.11.2014, është shprehur për pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e DRSSH Gjirokastrë t'i paguajë paditësit [REDAKTUAR], të ardhurat për sëmundjen, të vërtetuara me raport mjekësor të leshuar nga mjeku i familjes dhe Komisioni Mjekësor, nga data 01.04.2014 e në vazhdim". Për sa më sipër, rezultoi se z. [REDAKTUAR] është liruar nga detyra, ndërkohë që ka qënë me raport mjekësor, gjë që bërë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 147, pika 1 të Kodit të Punës. Në këto kushte, referuar nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri gjykon se [REDAKTUAR] është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë me persona të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme nga ana e DRSSH Gjirokastrë, për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore. Në këtë kontekst Komisioneri, në bazë të fakteve dhe provave të mësipërme, vlerëson se z. [REDAKTUAR] është diskriminuar për shkak të gjëndjes shëndetësore. Në bazë të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral (financiar), ndaj ankuesi duhet t'i drejtohet gjykatës, për të përfutur këtë dëmshpërblim".

Vendimi nr. 127 i është komunikuar DRSSH Gjirokastrë me shkresën e KMD nr. 765 prot, datë 07.09.2015, hyrë në protokoll në datë 08.09.2015 me nr. 407 prot.

Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr. 157, datë 04.11.2015, ka vendosur:

"1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodli: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.

3. Zbatimi i Vendimit nr. 127, date 07.09.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijëni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.

4. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij Vendimi.

5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim sipas ligjit"

Në pjesën arsyetuese të vendimit, KMB argumenton se:

"Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Gjirokastrë ka marrë dijëni për Vendimin nr. 127, datë 07.09.2015, e Komisionerit, por edhe pse ka kaluar afati ligjor, nuk e ka zbatuar rekomandimin e tij. Për sa më sipër, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Gjirokastrë ka dërguar pranë KMD-së, shkresën nr. 3774, datë 07.10.2015, ku shprehen kundërshtimet e këtij institucioni ndaj vendimit të Komisionerit, por nuk reflektohen masat e marra për zbatimin e tij. Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Komisioneri i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Gjirokastrë, me shkresën nr. 828/3, datë 12.10.2015, ku e informoi se vendimet e Komisionerit mund të ankimohen vetëm në rrugë gjyqësore. Referuar ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri e bëri me dije, gjithashtu, se në rast moszbatimi të vendimit nr. 127, datë 07.09.2015, KMD do të vendosë masë për ndëshkimin me gjobë të Drejtorisë

Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë. Në keto kushte, Komisioneri konstaton se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë nuk e ka zbatuar Vendimin nr. 127, datë 07.09.2015 e Komisionerit dhe është në shkelje të pikës 11, të nenit 33, të Ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohet: "Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporti brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni".

Vendimi nr. 157 datë 04.11.2015 i është komunikuar DRSSH Gjirokastrë me shkresën e KMD nr. 916/1 prot datë 04.11.2015, hyrë në protokollin e subjektit në datë 06.11.2015 me nr. 4192 prot.

Ndodhur në këto kushte pala paditëse DRSSH Gjirokastrë i është drejtuar në datën 10.11.2015 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesë padinë me objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 666 datë 16.12.2015 ka vendosur: "Të deklarojë moskompetencën territoriale për gjykimin e çështjes dhe kalimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjyimit të çështjes me vendimin nr. 1346, datë 18.03.2016, ka vendosur: Rrëzimin e padisë së palës paditëse Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 1346, datë 18.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

1. Lidhur me interesin e ligjshëm të palës paditëse: në thembër të kësaj padie qëndron pretendimi i palës paditëse ndaj akteve administrative vendimeve nr.127 datë 07.09.2015 dhe nr.157 datë 04.11.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi - disponimi i të cilave për konstatim të diskriminimit dhe marrjen e masave, cënon interesat e subjektit paditës. Duke patur në interesin e tij të ligjshëm të mos preket nga detyrime që pretendon se nuk qëndrojnë, pala paditëse justifikohet në ushtrimin e të drejtës së ngritjes së padisë për kundërshtimin e akteve administrative të nxjerrë nga pala e paditur KMD, sipas nenit 15/a të Ligjit 49/2012.
2. Lidhur me kushtet formale të respektimit të padisë: Gjykata i referohet ligjit të saj procedural nr.49 datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, dhe vëren se nga subjekti paditës nuk janë shkelur kushtet kryesore formale të rëndësishme për paraqitjen e padisë lidhur me natyrën e pavlefshmërisë së pretenduar, mospërmbushja e të cilave passjell disponimin e gjykatës për mospranimin e saj. Konkretisht: a) ankimi administrativ, sipas nenit 16, pika 1 e Ligjit 49/2012 nuk është kërkuar nga ligji specifik e në pasojë, padia mund të paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë në kuptim të nenit 16, pika 2/b të ligjit 49/2012. Asnjë nga dispozitat e ligjit 10 221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",

nuk parashikon ndonjë organ administrativ me tagra shqyrtimi të ankimit të subjekteve, ndaj të cilëve Komisioneri disponon me vendim për konstatimin e diskriminimit. Fakti që neni 33, pika 16 e ligjit 10221/2010, parashikon ankimin gjyqësor ndaj vendimit të Komisionerit për dënim me gjobë, nuk privon aksesin në gjykatë ndaj vendimit të natyrës si akti Nr.127 objekt shqyrtimi. Ligji 49/2012 tejkalon madje situatat kur organi publik vepron jo me akt administrativ, por me një veprim tjetër administrativ, kur thotë në nenin 17, pika 1/d të tij se: Padia ngrihet: ...d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë. Në rastin konkret, vendimet e KMD-së objekt gjykimi, janë akte administrative.b) Afati i paraqitjes së padisë: në kushtet kur natyra e pavlefshmërisë së akteve është pretenduar absolute, sipas nenit 18, pika 8 të ligjit 49/2012, afati nuk paraqet rëndësi, pasi pavlefshmëria absolute mund të ngrihet në çdo kohë. Nëse pavlefshmëria do të pretendohet në padi relative, afati 45 ditor i parashikuar nga neni 18, pika 1, shkronja "b" e Ligjit 49/2012 do vlerësohet i shkelur dhe padia do të ishte jashtë afatit, pasi vendimi bazë nr.127 datë 07.09.2015 i KMD (njoftuar pranë DRSSH Gjirokastër në datë 08.09.2015) është ankimuar në gjykatë në datë 16.11.2015, pra tej afatit ligjor. c) objekti i padisë përbën një nga disponimet e lejuara në gjykim administrativ, pasi pala paditëse ka kërkuar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, si një ndër objektet e parashikuara nga neni 17 i ligjit 49/2012, pika 1, shkronja "c" e të cilit, parashikon se padia ngrihet ndër të tjera edhe për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ.

- Lidhur me thelbin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata analizon paligjshmërinë e akteve administrative nën dritën e pavlefshmërisë absolute të tyre, pasi si në objektin e padisë, ashtu edhe në përfundim të saj, pikërisht kjo lloj pavlefshmërie është kërkuar të trajtohet nga gjykata. Sipas nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative, pika 1 e tij: "Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë". Sipas të njëjtës dispozite, organi administrativ kompetent mund të deklarojë në çdo kohë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Ndryshe nga pavlefshmëria relative e aktit administrativ (neni 115 i K.Pr.A) e cila lejon ardhjen e efekteve deri sa nuk është shfuqizuar, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike që nga koha e nxjerrjes së tij, pavarësisht nëse është deklaruar apo jo ende si i tillë. Nëse një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm e nuk prodhon asnjë pasojë juridike, qëndron logjika sipas të cilës, aktet e tjera administrative të nxjerra në zbatim të aktit të parë të pavlefshëm, janë gjithashtu të pavlefshëm. Sipas nenit 37 të ligjit 49/2012: "Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ". Në kuptim të nenit 37 të ligjit 49/2012, gjykata verifikon kuadrin ligjor të zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprimit administrativ, pra në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ, dhe jo ndryshimet ligjore të mëpasshme në kohë, por se ky përcaktim nuk prevalon ndaj sanksionimit të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative se akti i konstatuar absolutisht i pavlefshëm nuk ka sjellë asnjëherë pasoja juridike. Ky

- përcaktim është doktrinar dhe lidhet me mosveprimin e akteve absolutisht të pavlefshme.
4. Për shkak të cilësive të tilla të aktit absolutisht të pavlefshëm, neni 116 të KPA, parashikon një listë shteruese të situatave kur akti konstatohet si i tillë dhe gjykata i merr ato në analizë: -kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar: në rastin konkret, organi që ka disponuar me vendime KMD është subjekt i së drejtës tërësisht dhe qartazi i identifikuar. - kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore: KMD ka autoritetin dhe përgjegjësinë ligjore të dhënë nga ligji organik i saj nr.10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të hetojë situatat kur pretendohet diskriminim dhe të disponojë me vendime për konstatimin e saj dhe evidentimin e pasojave ligjore. Nuk rezulton ndonjë konfondim midis organesh për ushtrimin e këtij tagri nga ana e KMD-së dhe as u pretendua ndonjë i tillë nga pala paditëse. - kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji: jo vetëm që pala paditëse DRSSH Gjirokastër nuk referoi në ndonjë argument konkret për shkelje të procedurës së nxjerrjes së akteve, por në ecuri të veprimeve të kryera, pala e paditur ka ndjekur hapat e hetimit administrativ, duke venë në dijeni palën paditëse për çështjen dhe argumentet e ankuesit. Materiali procedimor është siguruar nga DRSSH Gjirokastër, pranë të cilës inspektorët e KMD kanë verifikuar të dhënat dhe kanë marrë sqarime. Sipas nenit 116 të KPA, natyra e pavlefshmërisë absolute sipas situatës "c" të kësaj dispozite, kërkon shkelje të tilla procedurale, të cilat të vlerësohen aq të rëndësishme për arritjen e vendimmarrjes, sa të argumentohet që nëse procedura do të ish respektuar, disponimi i organit publik do të kish qenë i kundërt me atë të nxjerrë. Në rastin konkret, pala paditëse DRSSH Gjirokastër nuk argumentoi asnjë mangësi në veprime procedurale.
5. Gjykata vëren se argumentet e dhëna nga pala paditëse në përmbajtje të padisë, nuk lidhen me pavlefshmëri absolute të akteve administrative, por me vlerësimin në themel të mosmarrëveshjes, pra me pretendime për shfuqizim të akteve administrative, si të nxjerra në kundërshtim me ligjin material (vlerësim të gabuar të ligjit). Pala paditëse ka depozituar nje padi e cila është kontradiktore midis pjesëve të saj për natyrën e pavlefshmërisë se akteve, dhe gjykata konstaton se akti bazë është vendimi konstatues për diskriminim nr.127 datë 07.09.2015, pasi vendimi i dënimit me gjobë i datës 04.11.2015 i KMD-së është derivat i tij. Pikerisht vendimi nr.127 datë 07.09.2015 i KMD-së është shqyrtuar nga kjo gjykatë vetëm nën argumentet për pavlefshmëri absolute, - siç është artikuluar pala paditëse qartazi në objektin e padisë dhe në pjesën fundore të saj, pasi për shfuqizimin e këtij akti (vendimit nr.127 datë 07.09.2015 të KMD-së), DRSSH Gjirokastër ka humbur afatin ligjor për t'iu drejtuar gjykatës.
6. Nga sa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se asnjë nga situatat e pavlefshmërisë absolute nuk gjen zbatim në vendimet e nxjerra nga KMD objekt i këtij gjykimi, ndaj padia nuk gjen mbështetje në ligj dhe prova dhe duhet të rrëzohet.
7. Lidhur me shpenzimet gjyqësore, të evidentuara gjatë gjykimit, ato janë në ngarkim të palës paditëse sipas nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile, dhe përbëhen nga tarifa për ngritjen e padisë në vlerën 3.000 lekë sipas mandatit të pagesës bankare datë 13.11.2015, paguar për llogari të gjykatës nga Drejtoria

Administrative e Apelit çmon se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: "...neni 116 i K.Pr.Administrative, parashikon një listë shteruese të situatave kur akti konstatohet absolutisht i pavlefshëm dhe gjykata i merr ato në analizë:

- kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar: në rastin konkret, organi që ka disponuar me vendime KMD është subjekt i së drejtës tërësisht dhe është i identifikuar.

-kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore: KMD ka autoritetin dhe përgjegjësinë ligjore të dhënë nga ligji organik i saj nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të hetojë situatat kur pretendohet diskriminim dhe të disponojë me vendime për konstatimin e saj dhe evidentimin e pasojave ligjore. Nuk rezulton ndonjë konfondim midis organesh për ushtrimin e këtij tagri nga ana e KMD-së dhe as u pretendua ndonjë i tillë nga pala paditëse.

-kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji: jo vetëm që pala paditëse DRSSH Gjirokastrë nuk referoi në ndonjë argument konkret për shkelje të procedurës së nxjerrjes së akteve, por në ecuri të veprimeve të kryera, pala e paditur ka ndjekur hapat e hetimit administrativ, duke venë në dijeni palën paditëse për çështjen dhe argumentet e ankuesit. Materiali procedimor është siguruar nga DRSSH Gjirokastrë, pranë të cilës inspektorët e KMD kanë verifikuar të dhënat dhe kanë marrë sqarime.

Sipas nenit 116 të KPA, natyra e pavlefshmërisë absolute sipas situatës "c" të kësaj dispozite, kërkon shkelje të tilla procedurale, të cilat të vlerësohen aq të rëndësishme për arritjen e vendimmarrjes, sa të argumentohet që nëse procedura do të ish respektuar, disponimi i organit publik do të kish qenë i kundërt me atë të nxjerrë...".

Referuar arsytimit sa sipër, Gjykata Administrative e Apelit ndan të njëjtin qëndrim dhe vlerësim me atë të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë duke theksuar se në rastin konkret, pala paditëse DRSSH Gjirokastrë nuk argumentoi asnjë mangësi në veprime procedurale."

Për pasojë, Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse nuk gjenden në asnjë prej rasteve të nenit 116 të K.Pr.Administrative për të qenë absolutisht të pavlefshme, siç me të drejtë ka vlerësuar dhe gjykata e shkallës së parë.

Së treti: Pala paditëse pretendon nëpërmjet ankimit se: Paditësi [REDAKTUAR] kishte arsim të mesëm dhe jashtë profilit për pozicionin e punës sipas rregullores së ISSH-s dhe për këtë shkak është larguar puna. Është gjykuar mosmarrëveshja e punës dhe është ekzekutuar nga pala e paditur vendimi i gjykatës që ka zgjidhur mosmarrëveshjen e punës.

Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Administrative e Apelit thekson se në rastin konkret objekt i gjykimit është vlerësimi i faktit të diskriminimit në kuadër të marrëdhënies së punës, fakt ky i konstatuar dhe i proceduar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe jo mosmarrëveshja e krijuar nga zgjidhja e kontratës së punës. Në këtë kuptim, objekt i këtij gjykimi referuar objektit të padisë të ngritur nga pala paditëse rezulton të jetë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. në këtë kuptim, gjykimi i mosmarrëveshjes së krijuar nga zgjidhja e kontratës së punës, apo ekzekutimi i vendimit gjyqësor që ka zgjidhur

konfliktin krijuar nga zgjidhja e kontratës së punës, nuk krijon pasoja juridike në çështjen objekt gjykimi.

Së katërti: pretendimi i palës paditëse se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim për çështje të arsimit dhe të shëndetit, është një pretendim i cili ka të bëjë me themelën e çështjes dhe në kushtet kur pala paditëse nuk ka ngritur pavlefshëmrinë relative në lidhje me aktin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është një pretendim që del jashtë kërkimeve të padisë.

Në nenin 6 të K.Pr.Civile përcaktohet se:

"Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet".

Sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga pala e paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit për kundërshtimin e vendimit nr. 1346, datë 18.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr.49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr.1346, datë 18.03.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1346, datë 18.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar. U shpall në Tiranë sot më datë 15.01.2019.

GJYQTAR

Alkelina GAZIDEDJA

d.v

GJYQTAR

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

d.v

Vërtetohet njësia me originalin

Kancelari
Leonard Stekaj
Brestaj

52823

